

FLETË FAKTIKE: RRUGA QË DO TË NDJEKIM NË AFGANISTAN DHE PAKISTAN

MISIONI YNË: Fjalimi i Presidentit riafirmon qëllimin themelor të formuluar në mars 2009: të pengohet, çrrënjoset dhe të mundet përfundimisht Al-Kaeda dhe të mos lejohet kthimi i tyre në Afganistan ose Pakistan. Për t'ia arritur këtij qëllimi, ne dhe aleatët tanë do të rrisim numrin e forcave tona, do të vëmë në shënjestër elementët rebelë dhe do të sigurojmë qendrat kryesore të popullatës, do të stërvisim forcat afgane, do t'ia kalojmë përgjegjësinë një partneri të aftë afgan dhe do të rrisim partneritetin me pakistanezët të cilët po përballen me të njëjtat kërcënime.

Ky rajon është zemra e ekstremizmit të dhunshëm global të ndjekur nga Al-Kaeda si dhe rajoni nga i cili ne u sulmuam më 11 shtator. Sulme të reja po planifikohen atje tani, një fakt i vënë në pah nga një komplot i kohëve të fundit, që është zbuluar dhe shkatërruar nga autoritetet amerikane. Ne nuk do ta lejojmë Talibanin të kthejë përsëri Afganistanin në një zonë strehimi nga ku terroristët ndërkombëtarë mund të na godasin ne ose aleatët tanë. Kjo do të përbente një kërcënim të drejtpërdrejtë kundër atdheut amerikan, dhe ky është një kërcënim që ne nuk mund ta tolerojmë. Al-Kaeda mbetet në Pakistan ku vazhdon të komplotojë sulme kundër nesh dhe ku si ajo ashtu dhe aleatët e saj ekstremistë përbëjnë një kërcënim për shtetin pakistanez. Synimi ynë në Pakistan është të sigurohet disfata e Al-Kaedës dhe të ruhet stabiliteti i Pakistanit.

PROCESI I SHQYRTIMIT: Shqyrtimi ishte një proces i matur dhe i disiplinuar prej tri fazash për të verifikuar përputhjen e objektivave, metodat për arritjen e këtyre objektivave dhe së fundi, burimet e duhura. Gjatë një periudhe prej dhjetë javësh, Presidenti kryesoi nëntë takime me ekipin e tij të sigurisë kombëtare, si dhe pati konsultime me aleatët dhe partnerët kryesorë, duke përfshirë qeveritë e Afganistanit dhe Pakistanit. Presidenti u përqëndrua në pyetjet e vështira, përdori kohën e nevojshme për të studiuar me kujdes të gjitha opsionet dhe për të pajtuar një sërë pikëpamjesh kontradiktore të anëtarëve të kabinetit, përpara se të binte dakord për të dërguar amerikanë të tjerë në luftë.

Si rezultat i këtij shqyrtimi, ne e kemi fokusuar më mirë misionin tonë dhe kemi zhvilluar një kuptimin e përbashkët në lidhje me qëndrimin tonë ndaj rajonit dhe nevojën për mbështetje ndërkombëtare. Ne do të dërgojmë trupa në Afganistan me shpejtësi dhe do të përfitojmë nga këto burime shtesë për të krijuar kushtet për të filluar tërheqjen e trupave ushtarake në verën e vitit 2011, duke mbajtur në të njëjtën kohë partneritetin me Afganistanin dhe Pakistanin për të mbrojtur interesat tona afatgjata në atë rajon.

Takimet u përqëndruan në mënyrën më të mirë për t'u siguruar që kërcënimi i Al-Kaedës të eliminohet nga rajoni dhe të rivendoset stabiliteti rajonal. Ne shqyrtuam nga afër përputhjen e përpjekjeve tona dhe ekuilibrin mes burimeve civile dhe ushtarake, si në Pakistan ashtu dhe në Afganistan, si dhe përpjekjet e SHBA dhe të komunitetit ndërkombëtar.

Një sërë çështjesh u shqyrtuan në thellësi: interesat kombëtare, objektivat dhe synimet thelbësore, përparësitë kundër terrorizmit, zonat e strehimit për grupet terroriste në Pakistan, fuqia e forcave ushtarake amerikane në botë, rreziqet dhe kostoja që shoqëron dislokimin e trupave, kërkesat globale të dislokimit, bashkëpunimi dhe angazhimi ndërkombëtar si për Afganistanin ashtu dhe Pakistanin, si dhe kapacitetet afgane në të gjitha fushat, duke përfshirë forcat afgane të sigurisë, qeverisjen qendrore dhe lokale, korrupsionin (përfshi tregtia e narkotikëve), dhe problemet e zhvillimit dhe ato ekonomike.

ÇFARË KA NDRYSHUAR PREJ MARSIT: Qysh kur Presidenti njoftoi përkushtimin tonë të ri në mars, një sërë ngjarjesh të rëndësishme e kanë shtyrë Administratën të rishikojë qëndrimin e vet ndaj Afganistanit dhe Pakistanit: Vëmendje e re iu përkushtua Afganistanit dhe Pakistanit, një udhëheqje e re amerikane iu dërgua në Afganistan, Pakistani rriti përpjekjet për të luftuar ekstremistët, ndërsa situata në Afganistan është rënduar më tepër.

Shtetet e Bashkuara caktuan një udhëheqje të re civile dhe ushtarake në Afganistan, me emërimin e ambasadorit Karl Eikenberry si ambasador amerikan në Afganistan dhe gjeneralit Stanley McChrystal si Komandant i ri i forcave ushtarake të ISAF (Forca Ndërkombëtare e Ndihmës së Sigurisë) në Afganistan. Me të mbërritur në Afganistan, si ambasadori Eikenberry ashtu dhe gjenerali McChrystal konstatuan se pas tetë vjet mungese të burimeve të mjaftueshme, situata ishte më keq se sa pritej. Së bashku, Eikenberry dhe McChrystal botuan një Plan të ri të Fushatës Civile-Ushtarake për të integruar përpjekjet amerikane në të gjithë vendin.

Procesi i vështirë, i tejzgjatur i zgjedhjeve në Afganistan si dhe shenjat evidente të mungesës së shtetit ligjor, venë në pah kufizimet e pushtetit qendror në Kabul.

Ndërkohë, në Pakistan, pakistanezët treguan vendosmëri të përtëritur për të shkatërruar militantët të cilët kishin marrë nën kontroll Luginën e Suatit, vetëm 60 milje nga Islamabadi. Udhëheqësit politikë pakistanezë, përfshi drejtuesit e partisë opozitare, u bashkuan në mbështetje të operacioneve ushtarake të Pakistanit. Këtë vjeshtë, pakistanezët e shtrinë luftën e tyre kundër ekstremistëve në zonat fisnore të Mehsudit në Vaziristanin Jugor, përgjatë kufirit me Afganistanin.

RRUGA PËRPARA - Presidenti ka vendosur të dislokojë edhe 30.000 trupa të tjerë amerikanë në Afganistan. Këta trupa do të dislokohen më me shpejtësi se sa ishte planifikuar fillimisht, për të përforcuar 68.000 amerikanë dhe 39.000 trupa të jo-amerikane të ISAF që ndodhen tashmë atje, me qëllim që të goditet kryengritja, të thuhet vrulli i saj dhe të sigurohen më mirë qendrat e populluara. Këto forca do të rrisin kapacitetin tonë për të stërvitur efektivisht Forcat Afgane të Sigurisë, dhe për t'u bërë partnerë me ta me qëllim që më shumë afganë të angazhohen në luftë. Duke ndjekur këto partneritete, ne mund t'ia kalojmë përgjegjësinë afganëve dhe të fillojmë tërheqjen e forcave tona ushtarake në verën e vitit 2011. Me pak fjalë, këto burime do të na japin mundësinë të bëjmë hovin përfundimtar të domosdoshëm për të stërvitur afganët, me qëllim që të transferojmë përgjegjësinë.

Ne do të ruajmë këtë nivel të lartë forcash gjatë 18 muajve të ardhshëm. Gjatë kësaj periudhe, ne do të masim rregullisht progresin tonë. Dhe duke filluar nga korriku i 2011, ne do të transferojmë

përgjegjësinë e parë të sigurisë tek afganët dhe do të fillojmë transferimin e forcave tona ushtarake nga Afganistani. Ndërsa afganët do të marrin përgjegjësinë për sigurinë e tyre, ne do të vazhdojmë të këshillojmë e ndihmojmë Forcat Afgane të Sigurisë dhe do të ruajmë partneritetin në emër të sigurisë së tyre, me qëllim që ata të përballojnë përpjekjet. Afganët janë të lodhur nga lufta dhe mezi presing paqe, drejtësi dhe siguri ekonomike. Ne kemi për synim që t'i ndihmojmë afganët të realizojnë këto synime dhe t'i japin fund kësaj lufte dhe kërcënimit të ripushtimit prej luftëtarëve të huaj të lidhur me Al-Kaedën.

Ne nuk do të jemi vetëm në këtë përpjekje. Ne do të vazhdojmë të luftojmë së bashku me afganët në këtë betejë dhe përpjekjet agresive për të krijuar partneritet, parashikuar nga gjenerali McChrystal, do të bëjë që një numër gjithnjë e më i madh afganësh t'i bashkohen luftës për të ardhmen e vendit të tyre. Do të kemi edhe burime të tjera shtesë nga NATO. Këta aleatë kanë bërë tashmë angazhimet të rëndësishme të tyre në Afganistan dhe ne do të diskutojmë kontribute të tjera të aleancës në ditët dhe javët që do të vijnë, si në trupa, ashtu dhe në trajnime dhe burime. Kjo nuk është vetëm një provë e besueshmërisë së aleancës—ajo që është në rrezik është më themelore. Është siguria e Londrës dhe Madridit; e Parisit dhe Berlinit; e Pragës, Nju Jorkut dhe në sensin më të gjerë, siguria jonë kolektive.

Ne do të punojmë me partnerët tanë, Kombet e Bashkuara dhe popullin e Afganistanit për të forcuar përpjekjet tona civile me qëllim që qeveria afgane të marrë pushtetin porsa që ne të përmirësojmë sigurinë. Fjalimi i inaugurimit i Presidentit Karzai dërgoi mesazhin e duhur për të lëvizur në një drejtim të ri, përfshi angazhimin e tij në ri-integrimin dhe pajtimin, përmirësimin e marrëdhënieve me partnerët rajonalë të Afganistanit dhe rritjen e vazhdueshme të përgjegjësisë të forcave afgane të sigurisë. Por ne duhet të shohim veprim dhe progres. Ne do të jemi të qartë për shpresat tona dhe do të vazhdojmë të inkurajojmë dhe përforcojmë ministritë afgane, guvernatorët si dhe udhëheqësit lokalë që punojnë për popullin dhe luftojnë korrupsionin. Ne nuk do të mbështesim ata që janë të papërgjegjshëm dhe që nuk veprojnë në shërbim të popullit dhe shtetit afgan. Ne do të përqendrojmë ndihmën tonë në fusha të tilla si bujqësia, të cilat mund të japin një ndikim të menjëhershëm në jetën e popullit afgan.

NDIHMA CIVILE: Një rritje e vazhdueshme dhe e konsiderueshme e numrit të ekspertëve civilë do të shoqërojë një infuzionin e rëndësishëm të ndihmës civile shtesë. Ata do të jenë partnerë afatgjatë me afganët për të forcuar kapacitetin e institucioneve qeveritare kombëtare dhe lokale dhe për të ndihmuar rehabilitimin e sektorëve kyç të ekonomisë afgane, me qëllim që afganët të mposhtin rebelët të cilët premtojnë veç rritje të dhunës.

Zhvillimi ka rëndësi kritike për eliminimin e joshjeve të momentit prej ekstremistëve dhe për rritjen e qëndrueshme të ekonomisë në një afat të gjatë. Përparësia jonë kryesore e rindërtimit është zbatimi i një strategjie civile-ushtarake të rihvillimit bujqësor për të restauruar sektorin bujqësor të Afganistanit që dikur lulëzonte. Kjo do të thajë burimin e rebelimit me luftëtarë dhe të ardhura nga kultivimi i lulekuqeve.

Theksi i përpjekjeve tonë qeverisëse do t'i vihet ngritjes së institucioneve më përgjegjëse, më të dukshme dhe më llogaridhënëse në nivel province, distrikti dhe atë lokal, aty ku afganët e thjeshtë takojnë qeverinë e tyre. Ne do të inkurajojmë dhe do të mbështesim planet repërtëritura

të qeverisë afgane për të luftuar korrupsionin, me masa konkrete për përparim drejt një llogaridhënieje më të madhe.

Një element kyç i strategjisë sonë politike do të jetë mbështetja e përpjekjeve të udhëhequra nga afganët për të ri-integruar Talibanët që denoncojnë Al-Kaedën, dorëzojnë armët dhe angazhohen në procesin politik.

PARTNERI YNË NË PAKISTAN: Partneriteti ynë me Pakistanin është i lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me përpjekjet tona në Afganistan. Për të siguruar vendin tonë, ne kemi nevojë për një strategji që funksionon në të dy krahët e kufirit afgano-pakistanez. Kostoja e mosveprimit është shumë më e madhe.

Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuar në forcimin e kapacitetit të Pakistanit për të vënë në shënjestër ato grupe që përbëjnë rrezikun më të madh për të dyja vendet tona. Ne nuk do të tolerojmë zona strehimi për terroristët e nivelit të lartë vendndodhja e të cilëve dihet dhe qëllimet e të cilëve janë të qarta. Për Pakistanin, ne vazhdojmë të inkurajojmë udhëheqjen civile dhe ushtarake për të vazhduar luftën e tyre kundër ekstremistëve dhe për të eliminuar zonat e strehimit për terroristët në vendin e tyre.

Tani ne jemi të përqendruar në punën me institucionet demokratike të Pakistanit, duke forcuar lidhjet mes qeverive dhe popujve tanë në lidhje me interesat dhe shqetësimet tona të përbashkëta. Ne jemi të përkushtuar për marrëdhënie strategjike afatgjata me Pakistanin. Ne e kemi afirmuar këtë angazhim ndaj Pakistanit duke i dhënë 1.5 miliard dollarë çdo vit për pesë vitet e ardhme në mbështetje të zhvillimit dhe demokracisë në Pakistan dhe duke udhëhequr një përpjekje globale për të inkurajuar zotime të tjera për mbështetje. Ky angazhim i konsiderueshëm e afatgjatë i asistencës ka objektivat e mëposhtëm:

- (1) Të ndihmohet Pakistani të kapërcejë krizat imediate për energji, ujë dhe kriza të tjera ekonomike, duke e thelluar në këtë mënyrë partneritetin tonë me popullin pakistanez dhe duke zvogëluar joshjen e ekstremistëve;
- (2) Të mbështeten reformat e gjera ekonomike të nevojshme për ta futur Pakistanin në rrugën e krijimit të qëndrueshëm të vendeve të punës dhe të rritjes ekonomike, të domosdoshme për stabilitetin dhe progresin afatgjatë të Pakistanit; dhe
- (3) Të ndihmohet Pakistani që të përdorë suksesin e tij kundër militantëve për të eliminuar strehat e ekstremistëve që kërcënojnë Pakistanin, Afganistanin, rajonin më gjerë dhe popujt në të gjithë botën.

Asistenca e mëtejshme amerikane do të ndihmojë Pakistanin të ndërtojë themelet për një zhvillim afatgjatë, si dhe do të forcojë lidhjet midis popullit amerikan dhe atij pakistanez duke demonstruar se Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuar për të zgjidhur problemet që prekin më shumë jetën e përditshme të pakistanezëve, ndërkohë që ne do të punojmë së bashku për të mposhtur ekstremistët që kërcënojnë Pakistanin ashtu sikurse kërcënojnë edhe Shtetet e Bashkuara.

###